

AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“DUBAI WORKER AGENCY” SH.P.K.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “**DUBAI WORKER AGENCY**” Sh.p.k.

- 1- SHEIMAA MAMDOUH MOHAMED HAMAD** atesia **MAMDOUH** , shtetas **EGYPTIANE** , lindur me 17.08.1985 ne **CAIRO**, identifikohet nepermjet pasaportes **A25028355**.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “**DUBAI WORKER AGENCY**” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

NENI 1
FORMA DHE EMRI

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale **SH.P.K.**, dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise “**DUBAI WORKER AGENCY**” **Sh.p.k.**,

NENI 2
BAZA LIGJORE


Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI3
SELI

A

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga “**DHIMITER KAJA** ” Lagja nr. 4,Godina kater kateshe perball Rifat Peshkatari ,kati i 2 ,apartamenti 22 ,Nr.

AKT THEMELIMI “DUBAI WORKER AGENCY”



Pronesia 3/121+1-2,zona kadastrale 8518 vol 121 faqa 169
, Durres, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**DUBAI WORKER AGENCY**” Sh.p.k. Punesime dhe Agjensi Turistike .Ne fushen e aktivitetit si operator turistik ,organizime te udhetimeve turistike rezervime hotelesh,organizimi dhe shitje te produkteve drejt agjensive te tjera turistike,organizim te eventeve ,konferencave ,trajnimeve jashte shtetit etj.Ne fushen e aktivitetit si agjensi punesimi ,ndermjetesimi ne fushen e punesimit dhe ne te gjitha fushat ,sherbim konsulence dhe ndermjetesim emigracioni per studime ,trajnime dhe formim professional Brenda dhe jashte vendit Pershkrimi I objektit te shoqerise ka natyre indikuese dhe jo kufizuese .Per realizimin e qellimit te shoqerise mund te bashkepunoj me cdo person fizik apo juridik ne cdo menyre qe e gjykon te dobishme .Shoqeria ne cdo kohe mund te ripercaktoj objektin e saj ,ta shtoje apo ta pakesoj ate me vendim te asamblese se shoqerise.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndarë në 1 pjesë .Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1. SHEIMAA MAMDOUH MOHAMED HAMAD	100,00%	100.000,00 LEKE
---	----------------	------------------------

AKT THEMELIMI “DUBAI WORKER AGENCY”

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7

AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, pervec këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “**DUBAI WORKER AGENCY**” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administratorët e shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare jane emeruar:

1. SHEIMAA MAMDOUH MOHAMED HAMAD

2.MOHAMED FATHY ABDELRAHMAN ABOUELANIN

Te cilet mund te ushtrojne kompetencat e tyre se bashku ,ose edhe vec e vec .

NENI 9

DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur

AKT THEMELIMI “DUBAI WORKER AGENCY”

secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane 21/02/2022

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
“DUBAI WORKER AGENCY” SH.P.K.**

SHEIMAA MAMDOUH MOHAMED HAMAD

شيماء ممدوح محمد حماد
شيماء



AKT THEMELIMI “DUBAI WORKER AGENCY”